

Testata: **Shqiptarja.com**

Pag: **on line**

Diffusione: **on line**

Data: **21/11/2015**


Periodicità: **quotidiano**



Press.com
THE MEDIA LINK

Informazione individuata su richiesta del fruitore per suo uso esclusivo. Riproduzione vietata.

[Shqiptarja.com]



Janë 25 të rinj nga gjithë vendet anetare në Euro Rajonin Adriatik Joninan, mes të cilëve pesë shqiptarë, të cilët prej dy muajsh po trajnohen në Ecapital Culture Start-up School në Ancona të Italisë se si të zhvillojnë projekt idetë e tyre në fushën e kulturës, me qëllim që të krijojnë sipërmarrje të cilat do të sjellin veç të mirave materiale edhe promovimin e vlerave pozitive. Kjo iniciativë është ndërmarrë nga Foncionie Marche në Ancona të Italisë në bashkëpunim me Euro Rajonin Adriatik Joninan dhe ente të tjera publike dhe private në Ancona që ka si qëllim dhënien e mundësisë të rinjve nga të tetë vendeve që shtrihen në brigjet e Adriatikut dhe Jonit të nisin bizneset e tyre dhe të krijojnë një rrjet bashkëpunimi ndërkultural në rajon. Për të bërë të njohur atë për çfarë është punuar në këtë inkubator profesional, të premtën më datë 20 nëntor, në godinën historike Molè Varvitelliana në Ancona, organizatorët e kësaj iniciative kanë zhvilluar një ceremoni ku kanë prezantuar misionin, strategjinë e tyre, por edhe projektet e 25 të rinjve nga gjashtë vende të Makro Rajonit Adriatik Joninan, Italia, Greqia, Kroacia, Shqipëria, Serbia dhe Bosnja e Herzekovina.

Në këtë aktivitet merrni pjesë jo pak personalitete të rëndësishëm si:

Francesco Merloni-President i Fondacionit Marche, Mario Pesaresi-President i Komuniteti Organozativ të Fondacionit Marche, Valeria Mancinelli-kruebashkiakja e Ankonës, Luca Ceriscioni-krjetare e rajonit Marche Sauro Longhi,-rektor i Universitetit Politeknik të Marche, Giorgio Cataldi-president i dhomës së tregëtisë në Ankona, Giuliano Catza-drejtor i përgjithshëm INSTAO, si dhe Cinzia De Marzo nga Komisioni Europian përfaqësuese e industrisë krahasuese zhvilluese dhe turizmit etj. Padyshim që pjesë e këtij diskutimi do të ishin dhe studentet e rajoneve ballkanike, ku për Shqipërinë foli studenti Edmond Hoxhaj. Gjithashtu ky aktivitet do të tregonte interesin e shumë medjave si: italiane, shqiptare, serbe, greke, kroate dhe ato boshnjake. Fondacioni Marche do të përbëhej nga mbështetësit e saj: Universita Politeknika Delle Marche, Camera di Compania Ancona, Comune di Ancona, INSTAO Distreto Culturale Evoluto, Fondazione Cariverona si dhe nga sponsorizimi INTESA SAMPAULO dhe UniCredit. Për çdo student është akrediuar një mbështetje financiare prej 7000 eurosh për një periudhë 85 ditore e thenë ndryshe një shipër 400.000 euro për gjithë studentet. Por cilat janë pritshmëritë e këtij fondacioni dhe sa japin për studentët që po trajnohen. Në mund të shkëpusnin disa intervista nga studentët tanë. Edmont Hoxhaj nga Fieri, Ilda Hodo nga Përmeti, Adela Makashi nga Tirana, Doreiza Selmani nga Vlora.

Sa ju vlen ky trajnim?

-Edmont Hoxhaj: Na vlen ky trajnim pasi na ka dhënë mjete instrumentale të cilët ne mund të kalojmë përtej kufive tanë të përditshmërisë, përtej punës sonë të përditshme, pasi aty jashtë është një botë e tërë me mundësi dhe në qoftë se ne do kërkojmë dhe do mundohemi të axhornohemi përditë atëherë do të jemi të barabartë dhe me kolegët në gjithë vendet e tjera të Europës dhe më gjerë pse jo në gjithë botën.

-Mendoni që në Shqipëri ka mungesë informacioni dhe nuk jemi aq të azhornuar në fakt?

-Atëherë edhe këtu në këtë shkollë është paraqitur si fakt që në të rinjtë në Amerikë kanë të tjera mundësi dhe janë më të avancuar sesa në Evropë. Të pranosh që të jesh biznesin i cili e ngre biznesin e tij mbi vlera jo vetëm mbi përfitime, në Amerikë tashtë është një rutinë, në Evropë është një risi. Në Shqipëri shpeshojmë të kthehet në risi pastaj më vonë në diçka të zakonshme.

Një tjetër intervistuese.

Cili është projekti yt?

Ilda Hodo -Unë merrem me restaurim dhe shtet arkeologjike në Shqipëri, për momentin si kartëvizitë Do punoj për krijimin e një laboratorit në muzeun arkeologjik të Tiranës se mungon totalisht dhe ky është pak a shumë fillimi. Pastaj do ecim gjithësi me muzetë e tjerë jo vetëm në këtu në Shqipëri po edhe në Kosovë e Serbi pse jo. Më sa kuptova nga bashkfolësi grupi i studenteve ka hedhur ide që të krijoni edhe bashkëpunime, jo vetëm në atdheun e secilit prej jush.

-Po, ne në fakt kemi shumë idera që bashkangjiten me projektet e të tjerëve, sepse normal nëse unë kam nevojë të restauroj një universitet, një muze, kështu bën një projekt mbi një tur, mund të organizojmë që të vijnë të vizitojnë muzeun, për shembull në Shqipëri.

Investimet në të ardhmen?

-Padyshim që në atdhe.

Por kemi dhe zëra që nuk mendojnë për momentin Shqipërinë.

Doreiza Selmani. -Kam shumë vite që jetoj në Ancona dhe kontributoj e mia do të vazhdojnë në Itali pasi atë e shoh si shtetin e dytë për mua, por dhe nuk shoh prespektiva për në Shqipëri, pasi duke lexuar gazeta të ndryshme apo lajme shoh që në Shqipëri nuk ka ende stabilizim fiskal për bizneset e reja sidomos, dhe për mua mendoj se është e vështirë të jetoj në Shqipëri.

Ju mendoni se kushtet e një biznesi janë më të favorshme në Itali?

Jo, por në Shqipëri është më e vështirë që të ambientohem me mënyrën e jetesës që jam mësuar, me rregullat e qarta dhe stabilizuese që janë këtu në Itali, megjithatë në të ardhmen nuk i dihet gjithësi.

Megjithatë u urojmë sa më shumë suksese këtyre të rinjve plot vision në kokë dhe shpresa për pritshmëritë e të ardhshmes në rrugën jo të lehtë të biznesit.

Përgatiti: Besnik Bedollari